

(2) Глоба во износ од 3.000 до 5.000 евра во денарска противвредност ќе се изрече за прекршок на друго правно лице, различно од ставот (1) на овој член, за кое е утврдено од надлежен орган дека извршило дискриминација согласно со членот 13 од овој закон.

(3) Глоба во износ од 200 до 500 евра во денарска противвредност ќе се изрече за прекршок од ставот (2) на овој член, на функционерот на државен орган, градоначалникот на единицата на локалната самоуправа или на службено лице на кое му е доверено вршење на јавно овластување.

(4) Глоба во износ од 100 до 250 евра во денарска противвредност ќе се изрече за прекршок на физичко лице, за кое е утврдено од надлежен орган дека извршило дискриминација согласно со членот 13 од овој закон.

Член 43

Одмерувањето на висината на глобата се врши во согласност со Законот за прекршоците.

Член 44

За прекршоците утврдени со овој закон прекршочна постапка води и прекршочна санкција изрекува надлежен суд.

VII. ПРЕОДНИ И ЗАВРШНИ ОДРЕДБИ

Член 45

(1) Јавниот оглас за избор на членови на Комисијата, Собранието на Република Северна Македонија ќе го објави во рок од 15 дена од денот на влегувањето во сила на овој закон.

(2) Првиот оглас за избор на членови на Комисијата за спречување и заштита од дискриминација, по влегувањето во сила на овој закон, не се објавува на веб-страницата на Комисијата

Член 46

Подзаконските акти предвидени со овој закон Комисијата ќе ги донесе во рок од шест месеци од денот на нејзиниот избор.

Член 47

Започнатите постапки за заштита од дискриминација, како и за поднесените претставки по кои не е започната постапка до денот на влегувањето во сила на овој закон, ќе завршат според одредбите од овој закон.

Член 48

Законите коишто содржат одредби кои се однесуваат на спречување и заштита од дискриминација ќе треба да се усогласат со овој закон во рок од две години од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Член 49

Овој закон влегува во сила со денот на објавувањето во „Службен весник на Република Северна Македонија“.

L I G J

I PARANDALIMIT DHE I MBROJTJES NGA DISKRIMINIMI (*)

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Lënda e Ligjit

Me këtë ligj rregullohen parandalimi dhe ndalimi i diskriminimi, format dhe llojet e diskriminimit, procedurat për mbrojtje nga diskriminimi, si dhe përbërja dhe puna e Komisionit të Parandalimit dhe të Mbrojtjes nga Diskriminimi.

Neni 2

Qëllimi i Ligjit

Qëllimi i këtij ligji është sigurimi i parimit të barazisë dhe parandalimi dhe mbrojtja nga diskriminimi në realizimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Neni 3

Zbatimi i Ligjit

(1) Ky ligj ka të bëjë me të gjithë personat fizikë dhe juridikë.

(2) Ky ligj zbatohet nga ana e të gjithë organeve shtetërore, organeve të njësave të vetëqeverisjes lokale, personave juridikë me autorizime publike dhe të gjithë personave të tjerë fizikë dhe juridikë në sferën e:

- 1) punës dhe marrëdhënieve të punës;
- 2) arsimit, shkencës dhe sportit;
- 3) sigurimit social, duke përfshirë edhe sferën e mbrojtjes sociale, sigurimit pensional dhe invalidor, sigurimit shëndetësor dhe mbrojtjes shëndetësore;
- 4) jurisprudencës dhe administratës;
- 5) banimit;
- 6) informimit publik dhe medimeve;
- 7) qasjes te të mirat dhe shërbimet;
- 8) anëtarësimit dhe veprimit në parti politike, shoqata, fondacione, organizata sindikale ose organizata tjera të bazuara në anëtarësim;

9) kulturës dhe

10) të gjitha sferave tjera.

(3) Subjektet, sipas paragrafit (2) të këtij neni, e kanë për дetyрë të ndërmarrin masa ose veprime për promovimin dhe avancimin e barazisë dhe parandalimit të diskriminimit.

(4) Тë gjithë subjektet që me ligj janë të дetyruara të grumbullojnë, evidentojnë dhe përpunojnë të dhëna, e kanë për дetyрë që këто të dhëna t'i paraqesin sipas bazave дискриминuese nga neni 5 i këtij ligji, përкатës për сферën, e me qëllim të promovimit dhe avancimit të баразисë dhe parandalimit të дискриминимит.

* Me këtë ligj bëhet harmonizimi me direktivat e Parlamentit European dhe të Këshillit, si në vijim: Direktivën nr. 2000/78/BE të Këshillit datë 27 nëntор 2000 për vendosjen e kornizës së përgjithshme të trajtimit të барабартë në punësimin dhe професионин, CELEX nr. 32000L0078; Direktivën nr. 2004/113/BE të Këshillit datë 13 dhjetor 2004 me të cilën zbatohet parimi i trajtimit të барабартë të meshkujve dhe të femrave në qasjen dhe сигуримин e mallrave dhe të shërbimeve, CELEX nr. 32004L0113 dhe Direktivën nr. 2006/54/BE të Parlamentit European dhe të Këshillit datë 5 korrik 2006 për zbatimin e parimit të mundësive të барабарта dhe trajtimit të барабартë të meshkujve dhe të femrave në сферën e punësimит dhe të професионеve (тë ripërpunuar), CELEX nr. 32006L0054.

Neni 4 Lista e nocioneve

Shprehjet e veçanta të përdorura në këtë ligj e kanë kuptimin në vijim:

1. “Barazi” është parimi sipas të cilit të gjithë njerëzit janë të barabartë, përkatësisht të barazuar në gëzimin dhe realizimin e të gjithë të drejtave dhe lirive;

2. “Person” është secili person fizik ose juridik;

3. “Person me pengesë” është personi i cili ka pamundësi afatgjate fizike, intelektuale, mentale ose senzore, që në ndërveprim me pengesat e ndryshme shoqërore, mund ta pengojë pjesëmarrjen e tij të plotë dhe efektive në shoqëri në bazë të barabartë me të tjerët;

4. “Përshtatje përkatëse” është ndryshimi dhe përshtatja e domosdoshme dhe përkatëse e nevojshme në rast të caktuar, që nuk shkakton ngarkesë joproporcionale ose të panevojshme, e me qëllim të sigurimit të gëzimit ose realizimit të të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive të personave me pengesë, në bazë të barabartë me të tjerët. Pamundësimi i përshtatjes përkatëse është diskriminim;

5. “Qasja të infrastruktura, të mirat dhe shërbimet” nënkupton ndërmarrjen e masave përkatëse që sigurojnë se personat me pengesë kanë qasje të rrethi fizik, transporti, informatat dhe komunikimi, në bazë të barabartë me të tjerët, duke përfshirë teknologji informatike dhe komunikuese dhe sisteme, të objektet tjera publike dhe shërbimet në zonat urbane dhe rurale. Pamundësimi i qasjes dhe arritshmërisë në infrastrukturë, të mira dhe shërbime është diskriminim;

6. “Grup i marginalizuar” është grup individësh të cilët i bashkon pozita specifike në shoqëri, që janë objekt i paragjyqimeve, që kanë karakteristika të veçanta që i bëjnë që t’i ekspozohen diskriminimit dhe/ose dhunës dhe mundësi më të vogël për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive;

7. “Qëllim i arsyetuar legjitim dhe objektiv” është qëllimi për realizimin e të cilit mjetet duhet të përputhen me nevojat reale në rast konkret, që jenë të përcaktuara saktësisht paraprakisht, të jenë të domosdoshme për realizimin e atij qëllimi, si dhe të jenë proporcionale me efektet që duhet të arrihen;

8. “Diskriminim sipas asociacionit” është çdo dallim, përjashtim ose kufizim i një personi për shkak të lidhjes me person ose grup tjetër në cilëndo bazë diskriminuese;

9. “Diskriminim sipas perceptimit” është çdo dallim, përjashtim ose kufizim i një personi për shkak të përkatësisë së supozuar ndaj grupit të caktuar në cilëndo bazë diskriminuese;

10. “Diskriminim i shumëfishtë” është diskriminimi i kryer ndaj një personi ose grupi në më shumë baza diskriminuese;

11. “Diskriminim i përsëritur” është diskriminimi i kryer ndaj një personi ose grupi më shumë herë, në baza të njëjta diskriminuese;

12. “Diskriminim i vazhduar” është diskriminimi që është kryer mbi një person ose grup pa ndërprerje, në periudhë më të gjatë kohore, në baza diskriminuese;

13. “Diskriminim interseksional” është secili diskriminim në dy ose më shumë baza diskriminuese që janë të lidhura njëkohësisht dhe në mënyrë të pandashme;

14. “Testim i situatës” paraqet metodë të vërtetësisë të diskriminimit nëpërmjet inkuadrimit të testerëve të organizuar që vihen në situatë krahasimtare që të hulumtohet paraqitja e diskriminimit në lëndë, procese dhe sfera të ndryshme, në cilëndo bazë diskriminuese.

Neni 5 Baza diskriminuese

Ndalohet çdo diskriminim në bazë të racës, ngjyrës së lëkurës, origjinës, përkatësisë nacionale ose etnike, seksit, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, përkatësisë në grup të marginalizuar, gjuhës, shtetësisë, prejardhjes sociale, arsimit, religjionit ose bindjes fetare, bindjes politike, bindjes tjetër, pengesës, moshës, gjendjes familjare ose martesore, statusit pronësor, gjendjes shëndetësore, cilësisë personale dhe statusit shoqërorë ose në cilëndo bazë tjetër (në tekstin e mëtutjeshëm: bazë diskriminuese).

Neni 6 Përkufizimi i diskriminimit

Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose dhënie e përparësisë që bazohet në bazë diskriminuese, me bërje ose mosbërje, që kanë për qëllim ose rezultat parandalimin, kufizimin, pranimin, gëzimin ose realizimin e të drejtave dhe lirive të personit ose grupit të caktuar në bazë të barabartë me të tjerë. Kjo i përfshin të gjitha format e diskriminimit duke përfshirë edhe pamundësimin e përshtatjes adekuate dhe pamundësimin e qasjes dhe arritshmërisë së infrastrukturës, të mirave dhe shërbimeve.

Neni 7 Masa dhe veprime që nuk paraqesin diskriminim

(1) Nuk do të konsiderohen si diskriminim masat dhe veprimet që merren me një qëllim të vetëm të mënjanohet gëzimi i pabarabartë i të drejtave dhe lirive të njeriut derisa nuk arrihet barazia faktike e personit apo grupit, nëse dallimi është i arsyeshëm dhe objektiv, ndërkaq mjetet për arritjen e atij qëllimi janë proporcionale, përkatësisht adekuate dhe të domosdoshme.

(2) Masat dhe veprimet sipas paragrafit (1) të këtij neni janë të kufizuara në kohë dhe zbatohen deri në aritjen e barazisë faktike të personave ose grupit gjatë gëzimit të të drejtave të tyre.

(3) Nuk do të konsiderohet si diskriminim:

1) Trajtimi i ndryshëm i personave të cilët nuk janë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut në lidhje me të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërkaq të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë dalin nga shtetësia e Republikës së Maqedonisë së Veriut;

2) Trajtimi i ndryshëm i personave në ndonjë nga bazat diskriminuese për shkak të natyrës së profesionit ose aktivitetit ose për shkak të kushteve në të cilat zhvillohet ai profesion, ndërkaq që paraqet kërkesë esenciale dhe vendimmarrëse, qëllimi është legjitim, ndërsa kushti nuk e tejkalon nivelin e nevojshëm për realizimin e tij;

II. FORMAT DHE LLOJET E DISKRIMINIMIT

Neni 8 Diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë

(1) Diskriminim i drejtpërdrejtë ekziston kur me një person ose me një grup veprohet, është vepruar ose do të veprohej në mënyrë më të pavolitshme në lidhje me një person ose grup tjetër në situatë faktike ose të mundshme krahasuese ose të ngjashme, në bazë diskriminuese.

(2) Diskriminim i tërthortë ekziston kur ndonjë person ose grup vihet në pozitë më të pavoritshme në krahasim me persona tjerë ose grup personash, nëpërmjet gjoja rregullave neutrale, dispozitave, kritereve, programeve ose praktikave, përveç kur dalin nga qëllimi legjitim, ndërkaq mjetet për arritjen e atij qëllimi janë proporcionale, përkatësisht janë adekuate dhe të domosdoshme.

Neni 9

Thirrja, nxitja dhe instruksioni për diskriminim

Thirrje, nxitje dhe udhëzim për diskriminim është çdo aktivitet me të cilin në mënyrë të tërthortë ose të drejtpërdrejtë bëhet thirrje, inkurajim, jepen udhëzime ose bëhet nxitje që të kryhet diskriminim në bazë diskriminuuese.

Neni 10

Shqetësimi

(1) Shqetësimi paraqet veprim të padëshiruar ndaj personit ose grupit të personave në baza diskriminuuese që ka për qëllim ose pasojë, shkeljen e dinjitetit ose krijimin e mjedisit kërcënues, armiqtësor, nënçmues ose të frikshëm, qasjes ose praktikës.

(2) Shqetësimi seksual është çfarëdo forme e veprimit të padëshiruar verbal, joverbal ose fizik të natyrës seksuale, që ka për qëllim ose pasojë, shkeljen e dinjitetit ose krijimin e mjedisit kërcënues, armiqtësor, nënçmues ose të frikshëm, qasjes ose praktikës.

Neni 11

Viktimizimi

Viktimizimi paraqet vuajtje të pasojave të dëmshme nga ana e personit për shkak të ndërmarrjes së veprimeve për mbrojtje nga diskriminimi, përkatësisht ka paraqitur diskriminim, ka filluar procedurë për mbrojtje nga diskriminimi, ka dëshmuar gjatë procedurës ose në mënyrë tjetër ka marrë pjesë në procedurë për mbrojtje nga diskriminimi.

Neni 12

Segregacioni

Segregacion është ndarje fizike e personit ose grupit të personave në bazë diskriminuuese pa qëllim të arsyetueshëm legjitim ose objektiv.

Neni 13

Forma më të rënda të diskriminimit

Si formë më e rëndë e diskriminimit, në kuptim të këtij ligji, llogaritet diskriminimi i shumëfishtë, diskriminimi interseksional, diskriminimi i përsëritur dhe diskriminimi i vazhduar.

III. KOMISIONI I PARANDALIMIT DHE I MBROJTJES NGA DISKRIMINIMI

Neni 14

Subjektiviteti juridik i Komisionit

(1) Komisioni I Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi është organ i pavarur dhe i mëvetësishëm i cili punon në pajtim me kompetencat e përcaktuara me këtë ligj (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni).

(2) Komisioni ka cilësi të personit juridik.

(3) Selia e Komisionit është në Shkup.

Neni 15

Buxheti i Komisionit

(1) Mjetet për punë të Komisionit sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke përfshirë edhe mjetet për aftësim përkatës për personat me pengesa.

(2) Mjetet për punë të Komisionit i përcakton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Komisionit.

(3) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut veçmas e voton pjesën që i ushtohet Komisionit në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(4) Me shfrytëzimin, shpërndarjen dhe dedikimin e mjeteve për punë të siguruara në ndarjen e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të dedikuar për Komisionin, Komisioni disponon në mënyrë të pavarur.

(5) Komisioni mund të sigurojë mjete edhe nga burime të tjera siç janë donacionet, grantet dhe të tjera.

Neni 16

Përbërja e Komisionit

(1) Komisioni përbëhet nga shtatë anëtarë të cilët i zgjedh dhe i shkarkon Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Anëtarët e Komisionit zgjidhen me mandat prej pesë vjetësh, me të drejtë të rizgjedhjes.

(3) Gjatë zgjedhjes së përbërjes së parë të Komisionit, katër anëtarë zgjidhen me mandat prej pesë vjetësh, kurse tre anëtarë me mandat prej tre vjetësh, me të drejtë të rizgjedhjes.

(4) Nga radhët e anëtarëve të zgjedhur sipas paragrafit (2) të këtij neni, Komisioni zgjedh kryetar me mandat prej një viti, pa të drejtë të rizgjedhjes.

(5) Anëtarët e Komisionit duhet ta pasqyrojnë përbërjen e shoqërisë në tërësi dhe gjatë zgjedhjes së anëtarëve të Komisionit zbatohen parimet e përfaqësimit adekuat të të gjitha grupeve shoqërore, parimim e përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të pjesëtarëve të bashkësive dhe pjesëmarrjen gjinore të balancuar.

Neni 17

Kushtet e zgjedhjes së anëtarëve të Komisionit

Anëtar i Komisionit mund të zgjidhet personi i cili i plotëson këto kushte:

1) të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;

2) të ketë marrë 240 kredi sipas sistemit SETK ose shkallë VII/1 të arsimit dhe ka minimum shtatë vjet përvojë pune në sferën e të drejtave të njeriut, nga të cilat pesë vjet në sferën e barazisë dhe mosdiskriminimit;

3) në momentin e emërimit, me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim me burg mbi gjashtë muaj ose ndalesë për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

(4) të mos jetë bartës i funksionit në parti politike.

Neni 18

Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Komisionit

(1) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut shpall konkurs publik për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit në së paku dy gazeta ditore që botohen në tërë

territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga të cilat njëra prej gazetave që botohet në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase. Konkursi detyrimisht publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", dhe në faqen e internetit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në faqen e internetit të Komisionit, në të gjitha gjuhët e bashkësive në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(2) Konkursi, sipas paragrafit (1) të këtij neni, zgjat 30 ditë nga dita e shpalljes së tij në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

(3) Komisioni i Çështjeve të Zgjedhjeve dhe të Emërimeve i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut përcakton propozim-listë të kandidatëve të paraqitur, pas debatit publik të kryer paraprakisht dhe në afat prej 14 ditësh, nga kalimi i afatit sipas paragrafit 2 të këtij neni, e dorëzon në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në shtojcë, me materialin e të gjitha kërkesave të dorëzuara dhe raportin e debatit publik të kryer.

(4) Nëse Kuvendi nuk zgjedh anëtarë të Komisionit, procedura e zgjedhjes përsëritet tërësisht me shpallje të konkursit publik menjëherë, e jo më vonë se dhjetë ditë.

Neni 19

Statusi i anëtarëve të Komisionit

(1) Anëtarët e Komisionit kanë status të personave të emëruar që funksionin e ushtrojnë në mënyrë profesionale dhe ajo është e papërputhshme me ushtrimin e funksionit tjetër publik, profesionit apo funksionit në parti politike. Anëtarit të Komisionit i pushon funksioni publik. Nëse anëtari i Komisionit para emërimit ka qenë në marrëdhënie pune, marrëdhënia e punës i pezullohet.

(2) Anëtarit të Komisionit të cilit i ka kaluar mandati do ta ushtrojë funksionin deri në emërimin e anëtarit të ri, por jo më gjatë se tre muaj.

(3) Anëtarët e Komisionit kanë të drejtë të rrogës dhe të kompensimeve të tjera, në pajtim me Ligjin e Rrogave dhe të Kompensimeve të tjera të Personave të Zgjedhur dhe të Emëruar.

Neni 20

Shkarkimi dhe pushimi i funksionit të anëtarit të Komisionit

(1) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut e shkarkon anëtarin e Komisionit, para kalimit të mandatit, me propozim të Komisionit të Çështjeve të Zgjedhjeve dhe të Emërimeve, nëse:

1) me vendim të plotfuqishëm i është shqiptuar ndalim për ushtrim të profesionit, të veprimtarisë ose të detyrës;

2) me vendim të plotfuqishëm gjyqësor është i dënuar me dënim me burg mbi gjashtë muaj;

3) përgjithmonë e ka humbur aftësinë psikofizike për ushtrim të funksionit, në pajtim me Ligjin dhe

4) e ushtron funksionin në mënyrë jo profesionale, të njëanshme dhe të pandërgjegjshme.

(2) Anëtarit të Komisionit i pushon mandati:

1) nëse vetë e kërkon atë;

2) për shkak të vdekjes;

3) me plotësimin e kushteve për pension të pleqërisë.

(3) Përmbushjen e kushteve për shkarkim, sipas paragrafit (1) të këtij neni, e përcakton Komisioni i Çështjeve të Zgjedhjeve dhe të Emërimeve, me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve, pas debatit publik të zhvilluar paraprakisht dhe paraqet nismë për

shkarkimin e anëtarit të Komisionit të Parandalimit dhe të Mbrojtje nga Diskriminimit të Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në shtojcë me raportin e debatit të zhvilluar publik.

(4) Kur anëtari i Komisionit shkarkohet ose i pushon funksioni, në pajtim me dispozitat sipas paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut shpall konkurs për emërimin e anëtarit të Komisionit, me mandat në kohëzgjatje deri në përfundimin e mandatit të anëtarit i cili ndryshohet.

Neni 21

Kompetencat e Komisionit

(1) Kompetencat e Komisionit:

1) ndërmerr aktivitete për promovim, mbrojtje dhe parandalim, për barazi, të drejtat e njeriut dhe jodiskriminim;

2) e ndjek zbatimin e këtij ligji dhe jep mendime dhe rekomandime;

3) i promovon parimin e barazisë, të drejtën e jodiskriminimit dhe menaxhimin e të gjitha formave të diskriminimit me anë të ngritjes së vetëdijes publike, informimit dhe edukimit;

4) kontribuon gjatë përgatitjes dhe zbatimit të programeve dhe materialeve nga sfera e arsimit formal dhe joformal;

5) përgatit dhe publikon raporte të posaçme dhe tematike për çështje të caktuara nga sfera e barazisë dhe jodiskriminimit;

6) jep rekomandime të përgjithshme për çështje të caktuara nga sfera e barazisë dhe jodiskriminimit dhe e ndjek zbatimin e tyre;

7) angazhohet për ratifikimin e marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe ndërkombëtare nga sfera e të drejtave të njeriut ose për qasje në to dhe e ndjek zbatimin e tyre;

8) kontribuon gjatë përgatitjes së raporteve që shteti është i detyruar t'ua paraqesë trupave ndërkombëtarë dhe rajonalë për të drejta të njeriut dhe kontribuon për zbatimin e rekomandimeve të tyre;

9) promovon dhe propozon harmonizimin e legjisllacionit nacional, dispozitave dhe praktikave, me instrumente ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut;

10) inicion ndryshim të dispozitave për shkak të zbatimit dhe përparimit të mbrojtjes nga diskriminimi;

11) jep mendim sipas propozimeve të ligjeve për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi;

12) vendos bashkëpunim me persona fizikë dhe juridikë, si dhe me shoqata, fondacione dhe partnerë socialë për realizimin e parimit të barazisë dhe promovimin e parandalimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi;

13) bashkëpunon me trupa përkatës nacionalë të shteteve të tjera, si dhe me organizata ndërkombëtare dhe rajonale në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi;

14) vepron sipas parashtrësive, miraton mendime, rekomandime dhe konkluzione për raste konkrete të diskriminimit;

15) inicon procedurë për mbrojtje nga diskriminimi sipas detyrës zyrtare;

16) jep informata për personin e interesuar për të drejtat e tij ose të saj dhe mundësi për inicionin e procedurës gjyqësore ose tjetër, për mbrojtje nga diskriminimi;

17) e ndjek realizimin e mendimeve dhe rekomandimeve për rastet konkrete të diskriminimit deri në zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Komisioni;

18) inicicion dhe paraqitet si ndërhyrës në procedura gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi;

19) me kërkesë të palëve ose me iniciativë personale mund të parashtrijë kërkesë që gjykata t'i mundësojë të veprojë si mik i gjykatës (amicus curiae);

20) çdo tre muaj e informon publikun për rastet e diskriminimit, në mënyrë të përcaktuar me akt të komisionit;

21) i ndan mendimet e veta, konstatimet dhe rekomandimet dhe i drejtohet publikut nëpërmjet cilësdo medie;

22) miraton rregullore për punë, plan vjetor dhe program për punë dhe akte të tjera në lidhje me punën e tij;

23) mund të formojë trupa këshillëdhënës nga ekspertë për çështje specifike të caktuara, të lidhura me përparimin, parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi;

24) grumbullon dhe publikon të dhëna statistikore dhe të dhëna tjera dhe formon baza të të dhënave në lidhje me diskriminimin;

25) paraqet në shqyrtim raport vjetor për punën e vet te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, më së voni deri më 31 mars në vitin paraprak, për vitin e ardhshëm;

26) të gjitha raportet, duke përfshirë dhe raportin financiar, i publikon në faqen e internetit të Komisionit.

(2) Komisioni siguron qasje gjatë zbatimit të kompetencave sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 22

Shërbimi profesional i Komisionit

(1) Formohet shërbim profesional për kryerjen e punëve profesionale, administrative dhe teknike të Komisionit.

(2) Komisioni miraton akte të posaçme me të cilat përcaktohet organizimi i brendshëm dhe sistematizimi për punën e shërbimit profesional.

(3) Të punësuarit në shërbimin profesional të Komisionit kanë status të nëpunësve administrativë dhe për to zbatohen dispozitat e Ligjit të Nëpunësve Administrativë.

IV. PROCEDURA E PARANDALIMIT DHE E MBROJTJES NGA DISKRIMINIMI PARA KOMISIONIT TË PARANDALIMIT DHE TË MBROJTJES NGA DISKRIMINIMI

Neni 23

Veprimi i Komisionit

(1) Personat të cilët konsiderojnë se kanë pësuar diskriminim mund të paraqesin prashtrësë te Komisioni, me procesverbal me shkrim ose me gojë, pa obligim për pagesë të taksës dhe kompensim tjetër.

(2) Personi i cili konsideron se është diskriminuar, para Komisionit mund të përfaqësohet nga shoqata, fondacioni ose sindikata me pëlqim të dhënë paraprakisht.

(3) Shoqatat, fondacionet, sindikatat ose organizatat tjera të shoqërisë civile dhe institucionet, që kanë interes të arsyeshëm për mbrojtje të interesave të një grupi të caktuar ose në korniza të veprimtarisë së tyre merren me mbrojtje nga diskriminimi, mund të paraqesin parashtrësë, nëse e bëjnë të besueshme se, me veprimin e personit të caktuar fizik ose juridik, janë diskriminuar një numër më i madh i personave.

(4) Komisioni ngre procedurë sipas detyrës zyrtare nëse nga rrethanat dhe faktet, si dhe nga informata e marrë pas informatës së arritur, në mënyrë bazë del se nga organet, sipas nenit 3 paragrafi (2) të këtij ligji, është kryer diskriminim në pajtim me bazat diskriminuese.

Neni 24

Elementet, gjuha dhe afatet e parashtrësës

(1) Parashtrësia duhet t'i përfshijë këto elemente: të dhënat për paraqitësin, të dhënat për personin kundër të cilit është paraqitur parashtrësia, rrethanat dhe faktet mbi të cilat bazohet parashtrësia, të dhënat mbi veprimet juridike që paraprakisht i ka investuar paraqitësi, nëse i ka, dhe nënshkrimi i paraqitësit.

(2) Nëse parashtrësia nuk i përmban elementet sipas paragrafit (1) të këtij neni ose është e paqartë, Komisioni do ta ngarkojë parashtruesin ta rregullojë në mënyrë plotësuese, në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të parashtrësës.

(3) Në procedurë para Komisionit zbatohen dispozitat e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve. Në komunikimin e drejtpërdrejtë me Komisionin mund të përdoret dhe gjuha e shenjave.

(4) Palët të cilat nuk e kuptojnë gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik kanë të drejtë për përkthyes.

(5) Parashtrësia mund të paraqitet më voni në afat prej gjashtë muajsh pas zbulimit të aktit të diskriminimit ose më së voni një vit nga dita kur ka ndodhur shkelja e kryer.

(6) Komisioni mund të iniciojë procedurë edhe pas kalimit të afatit, nëse konsideron se bëhet fjalë për rast që përfshin grup më të madh personash ose kur pasoja zgjat ose prek interesin publik.

(7) Komisioni e dorëzon parashtrësën për personin kundër të cilit është paraqitur, në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimit të parashtrësës dhe ai mund të deklarohet për dëshmitë në parashtrësë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të saj.

Neni 25

Parandalimi i konfliktit të interesave

Anëtarit i Komisionit do të përjashtohet nga puna në lëndën, me kërkesë personale ose me shumicë votash të Komisionit, nëse:

1) në lëndën në të cilin është zhvilluar procedura paraprakisht ka qenë i përfshirë ose ka qenë ose është palës, bashkëpronar, përkatësisht bashkëdetyrës, dëshmitar, ekspert, autorizues ose përfaqësues ligjor i palës;

2) me palën, me përfaqësuesin ose me autorizuesin e palës është farefis i gjakut në brezin e parë, kurse në vijë anësore, përfshirë deri në shkallë të katërt, bashkëshort/e ose i afërm i bashkëshortit/es deri në shkallë të dytë dhe atëherë kur martesë ka pushuar dhe / ose

3) me palën, me përfaqësuesin ose me autorizuesin e palës është në marrëdhënie të kujdestarit, birësuesit, të birësuarit, ushqyesit ose të ushqyerit.

Neni 26

Barra e vërtetësisë

Paraqitësi i parashtrësës i cili pohon se, sipas dispozitave të këtij ligji, është kryer diskriminim, është i detyruar t'i dëshmojë të gjitha faktet që e bëjnë pohimin të sigurt. Nëse Komisioni konstaton se pohimi është i sigurt, atëherë barra e vërtetësisë kalon te personi kundër të cilit është paraqitur parashtrësia.

Neni 27
Vendimet e Komisionit

(1) Komisioni jep mendim në afat prej 60 ditësh nga dita e paraqitjes së parashtresës dhe e ia dorëzon paraqitësit dhe personit kundër të cilit është paraqitur parashtresa.

(2) Me mendim me shkrim sipas paragrafit (1) t këtij neni, ndërkaq pas përcaktimit të diskriminimit, Komisioni rekomandon mënyrë të mënjanimi të shkeljes së të drejtës.

(3) Personi të cilit i është ofruar rekomandimi është i detyruar të veprjë sipas rekomandimit dhe ta mënjanojë shkeljen e të drejtës, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të rekomandimit ose në afat më të gjatë, nëse ekzistojnë shkaqe veçanërisht të arsyeshme, por jo më gjatë se gjashtë muaj, si dhe për këtë ta njoftojë Komisionin.

(4) Nëse personi të cilit i është drejtuar rekomandimi nuk vepron sipas rekomandimit në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni, Komisioni parashtron kërkesë për iniciimin e procedurës kundërvajtëse në gjykatën kompetente për kundërvajtje.

(5) Komisioni miraton konkluzion për mosveprim ose për ndërprerje të procedurës sipas parashtresës në rast kur procedura në gjykatë për të njëjtën punë tashmë është inicuar ose inicohet gjatë procedurës ose është e përfunduar në mënyrë të plotfuqishme dhe për këtë e njofton paraqitësin e parashtresës.

(6) Komisioni miraton konkluzion për mosinicism të procedurës për parashtresë për të cilën tashmë ka vepruar, kurse nuk janë ofruar fakte dhe rrethana të reja dhe për këtë e njofton parashtruesin.

(7) Komisioni miraton konkluzion për mosinicism ose për ndërprerje të procedurës nëse paraqitësi vendos ta tërheqë parashtresën gjatë kohës së veprimit.

(8) Komisioni miraton konkluzion për mosinicism ose për ndërprerje të procedurës nëse gjatë procedurës paraqitësi i parashtresës ka vdekur, përveç nëse pasardhësit nuk kërkojnë vazhdim të procedurës së filluar.

Neni 28
Rekomandim i përgjithshëm për mbrojtje nga diskriminimi

Komisioni, me nismë të vet u dërgon rekomandim të përgjithshëm në rast të diskriminimit numrit më të madh të personave.

Neni 29
Kryerja e kontrollit në dokumentacion dhe në lokale

(1) Në zbatimin e punëve nga kompetenca e vet, Komisioni mund të kryejë kontroll të drejtëpërdrejtë në dokumentacionin dhe në lokalet dhe të kërkojë të grumbulloj kopje nga dokumentet të lidhura me rastin e caktuar të lëndës nga të gjithë personat juridikë, organet shtetërore, organet e njësisve të vetadministrimit lokal, organe të tjera dhe organizata të cilat bëjnë autorizime publike dhe institucionet dhe shërbimet publike të cilat disponojnë me të dhëna dhe informata për raste dhe praktika të përgjithshme të diskriminimit, duke respektuar të drejtën e privatësisë.

(2) Anëtarët e Komisionit dhe të punësuarit në shërbimin profesional kanë legjitimacion zyrtar. Formulari, përmbajtja dhe mënyra e veprimit gjatë dhënies, shfrytëzimit dhe marrjes së legjitimacionit zyrtar janë përcaktuar me akt të përgjithshëm nga Komisioni.

Neni 30
Grumbullimi i të dhënave dhe informatave nga persona fizikë dhe juridikë

(1) Të gjithë personat fizikë dhe juridikë, organet shtetërore, organet e njësisve të vetëqeverisjes lokale, organet dhe organizatat tjera të cilat kryejnë autorizime publike dhe institucionet dhe shërbimet publike, janë të detyruara që, me kërkesë të Komisionit, të japin të dhëna për raste konkrete të diskriminimit dhe rekomandime të përgjithshme të diskriminimit në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

(2) Komisioni mund ta ftojë në bisedë secilin person i cili mund të japë informata të caktuara për raste të diskriminimit.

Neni 31
Bashkëpunimi me institucione që veprojnë ndaj parashtresave për mbrojtje nga diskriminimi dhe për të drejtat e njeriut

(1) Në kryerjen e punëve nga kompetenca e vet, Komisioni bashkëpunon me institucione që veprojnë ndaj parashtresave për mbrojtje nga diskriminimi dhe për të drejtat e njeriut për raste konkrete të diskriminimit.

(2) Komisioni e realizon bashkëpunimin sipas paragrafit (1) të këtij neni, nëpërmjet memorandumeve të bashkëpunimit që publikohen në ueb faqen e Komisionit.

V. MBROJTJA GJYQËSORE

Neni 32
Kompetenca dhe procedura gjyqësore

(1) Personi, i cili mendon se është i diskriminuar, mund të parashtrorjë ankesë në gjykatën civile kompetente.

(2) Në procedurë në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore, përveç nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

(3) Procedura është urgjente.

Neni 33
Kompetenca vendore

Në procedurën për mbrojtje nga diskriminimi, kompetent vendor është, përveç gjykatës me kompetencë gjyqësore vendore, edhe gjykata në territorin e së cilës është vendbanimi, përkatësisht selia e paditësit.

Neni 34
Padia

Me padinë sipas nenit 32 paragrafi (1) të këtij ligji, mund të kërkohet:

1) të përcaktohet se i padituri e ka shkelur të drejtën e paditësit, përkatësisht veprimin që e ka marrë ose nuk e ka marrë paraqet diskriminim;

2) të ndalohet marrja e veprimit me të cilin shkelet ose mund të shkelet e drejta e paditësit;

3) të detyrohet i padituri të marrë veprime me të cilat mënjanohet diskriminimi ose pasojat e tij;

4) të kompensohet dëmi material dhe jomaterial i shkaktuar me shkelje të të drejtave të mbrojtura me këtë ligj dhe

5) të publikohet në medie diapozitivi i aktgjykimit me të cilin është përcaktuar diskriminimi në format të qasshëm, me shpenzime të të paditurit.

(2) Kërkesat sipas paragrafit (1) të këtij neni mund të theksohen së bashku me kërkesat për mbrojtjen e të drejtave tjera për të cilat vendoset në procedurë kontestimore, nëse të gjitha kërkesat janë në lidhje të ndërsjellë dhe nëse gjykata e njëjtë është me kompetencë të vërtetë dhe vendore për to.

(3) Vendimi me të cilin urdhërohet shpallje në medie e detyron botuesin e medias, në të cilën duhet të publikohet dispozitivi i aktgjykimit, pa marrë parasyshë nëse ka qenë palë në procedurë.

Neni 35

Padia për mbrojtjen nga diskriminimi me interes publik (actio popularis)

(1) Shoqatat, fondacionet, sindikatat apo organizatat tjera të shoqërisë civile, dhe grupet formale të cilat kanë interes të arsyeshëm për mbrojtjen e interesave të grupit të caktuar apo në kornizat e veprimtarisë së tyre merren me mbrojtjen nga diskriminimi, mund të parashtrojnë padi, nëse e bëjnë të besueshme se, me veprimin e të paditurit, janë diskriminuar numër më i madh i personave.

(2) Në padinë sipas paragrafit (1) të këtij neni, mund të theksohet kërkesa:

1) të përcaktohet se i padituri ka kryer diskriminim mbi grupin interesat e të cilit i përfaqëson paditësi, përkatësisht veprimi që e ka marrë apo e ka lëshuar mund të shpie në diskriminimin e grupit;

2) të ndalohet marrja e veprimeve me të cilat diskriminohet grupi interesat e të cilit i përfaqëson paditësi;

3) të detyrohet i padituri të marrë veprime me të cilat mënjanohet diskriminimi apo pasojat e tij;

4) të publikohet në medie dispozitivi i aktgjykimit me të cilin përcaktohet diskriminimi në formatin e qasshëm, me shpenzim të të paditurit.

Neni 36

Masat e sigurisë

Para fillimit apo gjatë procedurës, me rastin e kërkesës së padisë, gjykata, me propozim të palës, mund të caktojë masa sigurie dhe pa e dëgjuar palën e kundërt, për shkak të mënjanimin të rrezikut urgjent nga dëmtimi i kundërligjshëm apo parandalimi i dhunës apo mënjanimin të dëmit të pakompensueshëm.

Neni 37

Barra e vërtetësisë

(1) Paditësi i cili pohon se, në pajtim me dispozitat e këtij ligji, është kryer diskriminim, ka për detyrë t'i prononcojë faktet që e bëjnë pohimin të besueshëm dhe atëherë barra e vërtetësisë i kalon të paditurit të dëshmojë se nuk ekziston diskriminim.

(2) Dispozita, sipas paragrafit (1) të këtij neni, nuk zbatohet në procedurë të kundërvajtjes dhe në procedurë ndëshkuese.

Neni 38

Dëshmitë

(1) Në procedurë gjyqësore për mbrojtjen nga diskriminimi, krahas dëshmimeve të përcaktuara në Ligjin e Procedurës Kontestimore, si dëshmi mund të shfrytëzohen edhe të dhënat statistikore, dhe/apo të dhënat e marra me testimin e situatës.

Neni 39

Shpenzimet gjyqësore

(1) Personat të cilët do të inicojnë procedurë gjyqësore për mbrojtjen nga diskriminimi janë të liruar nga pagesa e shpenzimeve për taksa gjyqësore.

(2) Shpenzimet për taksa gjyqësore për personat sipas paragrafit (1) të këtij neni, hiqen nga Buxheti të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 40

Pjesëmarrja e personave të tretë

(1) Në seancën gjyqësore lidhur me padinë sipas nenit 34 të këtij ligji, si ndërhyrës nga ana e personit i cili pohon se është i diskriminuar, mund të bashkëngjitet organi, organizata, institucioni, shoqëria, sindikata ose personi tjetër i cili në kuadër të veprimtarisë së vet merret me mbrojtjen e të drejtave të barazisë dhe mosdiskriminimit për të cilat të drejta vendoset në procedurë.

(2) Për pjesëmarrjen e personit të përzier vendos gjykata me zbatimin e dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

VI. DISPOZITA KUNDËRVAJTËSE

Neni 41

(1) Gjobë në shumë prej 400 deri në 10.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik për të cilin është konstatuar nga organi kompetent se ka kryer diskriminim në pajtim me nenin 6, lidhur me nenin 4 pika 4 dhe 5, nenin 8, nenin 9, nenin 10, nenin 11 nenin 12, nenin 29 dhe nenin 30 të këtij ligji në mënyrën si vijon: prej 400 deri 1000 euro në kundërvlerë denari për mikro tregtarë, prej 600 deri 2.000 euro në kundërvlerë denari për tregtarë të vegjël, prej 800 deri 10.000 euro në kundërvlerë denari për tregtarë të mesëm dhe prej 1.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë denari për tregtarë të mëdhenj.

(2) Gjobë në shumë prej 400 deri në 2.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit tjetër juridik të ndryshëm nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, për të cilin është konstatuar nga organi kompetent se ka kryer diskriminim në pajtim me nenin 6, lidhur me nenin 4 pika 4 dhe 5, nenin 8, nenin 9, nenin 10, nenin 11 nenin 12, nenin 29 dhe nenin 30 të këtij ligji.

(3) Gjobë në shumë prej 100 deri 400 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje sipas paragrafit 2 të këtij neni, funksionarit të organit shtetëror, kryetarit të komunës në njësinë e vetëqeverisjes lokale ose personit zyrtar të cilit i është besuar kryerja e autorizimeve pblike.

(4) Gjobë në shumë prej 50 deri 150 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik për të cilin është konstatuar nga organi kompetent se ka kryer diskriminim në pajtim me nenin 6, lidhur me nenin 4 pika 4 dhe 5, nenin 8, nenin 9, nenin 10, nenin 11 nenin 12, nenin 29 dhe nenin 30 të këtij ligji.

Neni 42

(1) Gjobë në shumë prej 3.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik për të cilin është konstatuar nga organi kompetent se ka kryer diskriminim në pajtim me nenin 13

të këtij ligji në mënyrën si vijon: prej 3.000 deri në 5.000 euro në kundërvlerë denari për mikro tregtarë, prej 4.000 deri 6.000 euro në kundërvlerë denari për tregtarë të vegjël, prej 5.000 deri 8.000 euro, në kundërvlerë denari, për tregtarë të mesëm dhe prej 6.000 deri 10.000 euro, në kundërvlerë denari, për tregtarë të mëdhenj.

(2) Gjобë në shumë prej 3.000 deri 5.000 euro, në kundërvlerë denari, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit tjetër juridik të ndryshëm nga paragrafi 1 i këtij neni, për të cilin është konstatuar nga organi kompetent se ka kryer diskriminim në pajtim me nenin 13 të këtij ligji.

(3) Gjобë në shume prej 200 deri 500 euro, në kundërvlerë denari, do t'i shqiptohet për kundërvajtje sipas paragrafit 2 të këtij neni, funksionarit të organit shtetëror, kryetarit të komunës në njësinë e vetëqeverisjes lokale ose personit zyrtar të cilit i është besuar kryerja e autorizimeve publike.

(4) Gjобë në shumë prej 100 deri 250 euro, në kundërvlerë denari, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik, për të cilin është konstatuar nga organi kompetent se ka kryer diskriminim në pajtim me nenin 13 të këtij ligji.

Neni 43

Peshimi i lartësisë së gjобës për personin juridik kryhet në pajtim me Ligjin e kundërvajtjes.

Neni 44

Organi i kundërvajtjes

Për shkeljet e përcaktuara në këtë ligj, procedurë të kundërvajtjes drejton dhe sanksione të kundërvajtjes shqipton gjykata kompetente.

VII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 45

(1) Konkursin publik për zgjedhje të anëtarëve të Komisionit, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut do ta shpallë në afat prej 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Konkursi i parë për zgjedhje të anëtarëve të Komisionit të Parandalimit dhe të Mbrojtjes nga Diskriminimi, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk shpallet në ueb faqen e Komisionit.

Neni 46

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj, Komisioni do t'i miratojë në afat prej gjashtë muajsh nga dita e zgjedhjes së tij.

Neni 47

Procedurat e filluara për mbrojtje nga diskriminimi, si dhe për parashtrësata e paraqitura, për të cilat nuk ka filluar procedura deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të përfundojnë sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 48

Ligjet që përmbajnë dispozita që kanë të bëjnë me parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi do të duhet të harmonizohen me këtë ligj në afat prej dy vitesh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Neni 49

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

ПРЕТСЕДАТЕЛ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

3372.

Врз основа на член 84, алинеја втора од Уставот на Република Северна Македонија („Службен весник на Република Македонија“ бр. 52/91, 1/92, 31/98, 91/01, 84/03, 107/05, 3/09, 49/11 и 6/19), донесувам

УКАЗ

ЗА ПОСТАВУВАЊЕ НА ДОЛЖНОСТА ВО НРЕДЕН И ОПОЛНОМОШТЕН АМБАСАДОР НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА ВО ПОСТОЈАНАТА ДЕЛЕГАЦИЈА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА ПРИ НАТО

I

Г. Дане Талески се поставува на должноста во нреден и ополномоштен амбасадор на Република Северна Македонија во Постојаната Делегација на Република Северна Македонија при НАТО, со седиште во Брисел.

II

Министерот за надворешни работи ќе го изврши овој указ.

III

Овој указ влегува во сила со денот на објавувањето во „Службен весник на Република Северна Македонија“.

Указ број 21
27 октомври 2020 година
Скопје

Претседател на Република
Северна Македонија,
Стево Пендаровски, с.р.

ВЛАДА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

3373.

Врз основа на член 19 став (7) од Царинскиот закон („Службен весник на Република Македонија“ бр. 39/05, 4/08, 48/10, 158/10, 44/11, 53/11, 11/12, 171/12, 187/13, 15/15, 129/15, 154/15, 192/15, 23/16 и 144/18), Владата на Република Северна Македонија, на седницата, одржана на 20 октомври 2020 година, донесе

ОДЛУКА

ЗА УКИНУВАЊЕ НА УВОЗНАТА ДАВАЧКА - ЦАРИНСКАТА СТАПКА ЗА ЗАМРЗНАТО СВИНСКО МЕСО И СВИНСКО САЛО ИСЧИСТЕНО ОД МЕСО И ЖИВИНСКО САЛО, НЕИСТОПЕНИ ИЛИ ПОИНАКУ ИЗДВОЕНИ, СВЕЖИ, РАЗЛАДЕНИ, ЗАМРЗНАТИ, СОЛЕНИ, ВО САЛАМУРА, СУШЕНИ ИЛИ ЧАДЕНИ

Член 1

Со оваа одлука се пропишува мерка за укинување на увозните давачки-царинската стапка при увоз на следните стоки во следните количини: